



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 04.12.2012, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kosumi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Fetah Salihu, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Lumnie Rama, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Shefqet Sylejmani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja, Afërdita Veliu dhe Engin Beyoglu.

Munguan: Tefik Mehmeti, Remzi Pacolli, Shemsi Veseli, Besa Halimi – Zagragja dhe Astrit Hasani.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të shoqërisë civile dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, **kryesuesi** i njoftoi të pranishmit, duke shtuar se është edhe një aneks i bartjes së mjeteve, kryesisht që ka të bëjë me subvencionimin e bujqve, pra është një kategori e ndryshimit, në mënyrë që të bashkohet me pjesën që është në pikën e dhjetë të rendit të ditës. Ai falënderoi anëtarët e Kuvendit, Kryetarin dhe ekzekutivin për mirëkuptimin që e kanë treguar për situatën që u krijua lidhur me rastin e tij. I siguroi ata për punën e tij si kryesues i Kuvendit, duke thënë se që nga dita e parë në këtë post, asnjëherë nuk kam shkelur procedura dhe nuk kam bërë keqpërdorim të detyrës zyrtare, dhe e gjithë kjo konsideroj që është një keqkuptim. Besoj se organet e drejtësisë shumë shpejt do ta ndriçojnë rastin.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoi që në kuadër të rendit të ditës, të futet për diskutim edhe çështja e grevës së zjarrfikësve, për të cilën opinioni tashmë është në dijeni dhe relativisht i shqetësuar. Kjo tashmë ka hyrë në një situatë të prosperuar, për të cilën ende nuk ka zgjidhje. Kuvendarëve ju kujtoj se më 28 shtator të vitit të kaluar, Kryetari e ka pas nënshkruar një dokument, aktemërim, apo kështu diçka është quajtur, dhe do të ishte në të mirën, në nderin dhe obligimin e këtij Kuvendi që të trajtojë çështjen e ngritur, sepse të gjitha kërkesat, më sa i kemi vërejtur ne si GP, janë brenda ligjit. Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Ramabaja rreth grevës së zjarrfikësve, prof. dr. **Isa Mustafa** tha se ne do t'i kryejmë obligimet tona dhe do t'iu paguhen orët shtesë që kanë mbetur për tre muajt e vitit të kaluar dhe gjysmëvjetori i këtij viti. Në bazë të ligjit, ne nuk mund të marrim mbi vete obligime tjera, për arsye se ajo që maksimalisht mund të bëjmë, janë 40 orë në muaj, që ne mund t'iu paguajmë si orë shtesë, dhe nuk mund të paguajmë asgjë tjetër. Në qoftë se ligji më vonë mund ta lejojë, ose në qoftë se e marrim pëlqimin e organeve të Qeverisë, është çështje tjetër.

Me shumicë votash, dy kundër (Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu), u miratua ky

R E N D D I T E:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë;**
- 2. Propozimvendimi për dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhim NPL "Hortikultura" SH.A.;**
- 3. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale;**
- 4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së;**
- 5. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit rinor lokal - Prishtinë 2013-2015;**
- 6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve në pronësi të Komunës;**
- 7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Nëntë Jugoviq;**
- 8. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", në Prishtinë;**
- 9. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" në Prishtinë;**
- 10. Propozimvendimi për fletëtransfer të mjeteve financiare;**

11. Propozimvendimi për transfer të mjeteve financiare në shumën prej 100.000 €, mjete të cilat barten në subvencione për bujq për të mbjellurat vjeshtore.
12. Pyetje dhe pergjigje;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhim NPL "Hortikultura" SH.A., të pranishmit i njoftoi Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, duke cekur se ky objekt është i ndërtuar në kuadër të kompleksit të varrezave të qytetit të Prishtinës. Është ndërtuar në parcelë komunale, në kuadër të një plani detaj urbanistik të mëhershëm, me investime të Komunës dhe ka për destinim ofrimin e shërbimeve mortore për qytetarë.

Vjollca Rizani tha se GP i LDK-së e ka shqyrtuar këtë propozimvendim dhe njëzëri jemi për marrjen e vendimit që ka të bëjë me dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim NPL "Hortikultura", në afat për dhjetë vjet, me mundësi vazhdimi.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se një objekt i tillë ka qenë më se i nevojshëm për qytetin e Prishtinës. Propozoi që ajo kompani që bën mbikëqyrjen e varrezave, ta ketë në mbikëqyrje edhe këtë objekt, për aq kohë sa është e caktuar mbikëqyrja e varrezave, pra janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Si i GP këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Skënder Reçica tha se GP i PDK-së e mbështet propozimvendimin për dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhim NPL "Hortikultura".

Rëndësia e këtij objekti pa dyshim se është shumë e veçantë për qytetarët e Prishtinës. Ajo që do të duhej të ishte në këtë propozimvendim, ka të bëjë me pikën 4 - kushtet tjera, rreth shfrytëzimit dhe menaxhimit, që të paktën me dy-tri fjali të ceket se cilat do të jenë kushtet e menaxhimit që do t'i ofrojë NPL "Hortikultura".

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe në KPF e kemi shprehur një mirënjohje për Komunën e Prishtinës. Ky është një sukses i të gjithëve bashkërisht, të gjitha GP-ve këtu, ngase një objekt i tillë ka qenë më se i

nevojshëm për komunën e Prishtinës. Prandaj, përveç që e përkrahim këtë, është rendi të shprehet edhe një mirënjohje për këtë punë vërtetë të shkëlqyer.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, këtë e vlerësoi si një punë të mrekullueshme, sepse njerëzit kanë pasur nevojë për një shërbim të tillë. Duhet pasur bashkëpunimi me Bashkësinë Islame, që ajo të shfrytëzohet sa më mirë, sepse po ndërtohen disa objekte dhe nuk po shfrytëzohen.

Edhe ne do të duhej të kishim një informatë për këtë pjesën e fundit të fjalisë që detajizon marrëveshjet, për të ditur se si kryhen shërbimet, ka apo nuk ka pagesë për ato shërbime, sa do t'iu kushtojnë ato shërbime qytetarëve, a janë ato shërbime të larta a si janë etj.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, shprehu mendimin se çështja e mirëmbajtjes së varrezave, krahasuar me mirëmbajtjen e objekteve të tjera, është diçka më delikate. Në frymë të asaj, propozoj një shtesë në pasusin e fundit, që është pasusi për marrëveshje të veçantë, aty mund ta mendoni a do të jetë pesë apo dhjetë vjet, me iu lënë një mundësi qytetarëve, dhe ta japin një vlerësim se janë apo nuk janë të kënaqur me ato shërbime.

Gjithashtu në pjesën ku përfundon fjalia "... me marrëveshje të veçantë mes Komunës dhe Hortikulturës", propozoj t'i shtohet "... në konsultim dhe bashkëpunim me institucionin përkatës të Bashkësisë Islame në Prishtinë".

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, theksoi se këtë propozimvendim e shqyrtuam dhe mendimi ynë është se për këtë është marrë një vendim i drejtë në shërbim të qytetarëve. Ne e mbështesim propozimin që Hortikultura ta menaxhojë për aq kohë sa ka statusin e ndërmarrjes publike dhe është nën përkujdesje, respektivisht i jep llogari Komunës, por jo të afatizohet për pesë, dhjetë apo më shumë vjet.

Prishtina është kryeqendër, por këtu nuk janë të gjithë myslimanë, andaj në dokumente të kësaj natyre nuk do të ishte mirë që të implikohet konfesionin. Le t'u mbetet familjeve në vullnetin e tyre të bashkëpunojnë apo jo me Bashkësinë Islame, sepse ne po nxjerrim një akt juridik, dhe nuk jemi ne këtu në shërbim të Bashkësisë Islame.

Me shumicë votash, një abstenim, u miratua Vendimi për dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhim NPL "Hortikultura" SH.A.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Valbon Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, i cili tha se këto ndryshime të kësaj rregulloreje janë më tepër reflektim i punës, gjegjësisht përvojës së komisionit që ka punuar dhe i ka hasur në terren në vitin e kaluar.

Sali Krasniqi tha se GP i LDK-së e ka shqyrtuar këtë propozimvendim dhe e përkrahim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë propozimvendim e kemi shqyrtuar dhe vërejtjet që janë dhënë në KPF janë pranuar, andaj grupi ynë e përkrah miratimin e këtij propozimvendimi.

Skënder Reçica, në emër të GP i PDK-së, tha se këtë propozimvendim e kemi shqyrtuar dhe besojmë se ndryshimet që janë bërë, janë bërë në bazë të praktikave nga rastet e mëparshme, andaj ne si GP e përkrahim për miratim.

Shefqet Sulejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se janë marrë parasysh të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që janë dhënë në KPF, andaj dhe kemi konstatuar që jemi të gatshëm ta përkrahim për miratim. Lidhur me këtë çështje ne kemi një kërkesë, që mundësisht banesat të ndahen në afatin sa më të shpejtë.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, i përkrahu ndryshimet që janë bërë, përveç te kriteret e vlerësimit, ku mendoj se diç nuk është në rregull, andaj kërkoj një sqarim. P.sh. për pjesëmarrje në luftë 3 pikë, për invalidët e luftës 4 pikë, për familje të dëshmorëve 3 pikë. Kjo ndoshta është dashur të bëhet ndryshimi dhe plotësimi për anëtarë të familjeve të dëshmorëve, pra këto pikë do duhej të ishin në rregulloren tjetër, se edhe rast social, edhe familje e dëshmorëve, mendoj se nuk shkojnë të dyja bashkë.

Lidhur me vërejtjet e dhënë nga znj. Rafuna, **Valbon Krasniqi** dha sqarime të nevojshme.

Feti Mehdiu në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, përkrahu sugjerimet e dhëna nga parafolësit, si dhe miratimin e rregullores.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se gjithmonë jemi në përkrahje të shërbimit të qytetarëve dhe duhet të vazhdohet më tutje me forma të ngjashme.

Kryesuesi tha se këto plotësime dhe ndryshime rrjedhin kryesisht nga puna e komisioneve që kanë hasur në terren. Këto ndryshime dhe plotësime të kësaj rregulloreje e lehtësojnë punën e komisionit, që në të ardhmen të mos vijmë në një situatë jo të favorshme.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale.

Pika e katërt

Përkitazi me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, të pranishmit shkurtimisht i informoi Valbon Krasniqi.

Kryesuesi tha se këto ndryshime dhe plotësime u trajtuan nga grupet parlamentare dhe po shihet se nuk ka ndonjë vërejtje.

Sadri Ramabaja, në emër të LV bëri një sugjerimi, duke thënë se, pasi që ligji ia lejon Kuvendit që këtë kategori të personave ta trajtojë në mënyrë të veçantë, kisha kërkuar që këto banesa të jepen në shfrytëzim, e jo me qira. Lidhur me kërkesën e z. Ramabaja, **kryesuesi** dha sqarime shtesë.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së.

Pika e pestë

Për Propozimvendimin për miratimin e Planit të veprimit rinor lokal – Prishtinë 2013-2015, informoi Agim Salihu, i cili tha se ky plan është punuar në bazë të Ligjit nr. 03 L 145, për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, dhe në bazë të nenit 10, pikat 1.2, 1.3, 2.6, 2.8 të Udhëzimit administrativ.

Bekim Gashi, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë projektplan, pra është një plan i veprimit rinor lokal, gjithëpërfshirës për të rinjtë e Prishtinës, duke u bazuar në nevojat dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Ky Plan ka të bëjë me shumicën e çështjeve dhe problemet me të cilat të rinjtë e Prishtinës ballafaqohen çdo ditë. Plani përcakton edhe mënyrën e qasjes së politikave rinore komunale ndaj të rinjve dhe iu dedikohet të rinjve të moshës 15-24 vjeç.

GP i LDK-së vlerëson lart hartimin e këtij plani gjithëpërfshirës dhe e përkrah për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se është për t'u përshëndetur puna e drejtoreshës, e cila punon me të gjitha kategoritë dhe ka bërë projektplane edhe për rininë lokale të Prishtinës. Më mirë të jetë një projektplan, sesa mos të ketë hiq, me të cilin do të punojë rinia e qytetit. Si GP e përkrahim për miratim.

Skënder Reçica, në emër të GP të PDK-së, shprehu gëzimin dhe përkrahjen që tani më të rinjtë e Prishtinës e kanë një plan të veprimit, duke qenë se ky plan i veprimit trajton një mori çështjesh dhe problemesh me të cilat ballafaqohet rinia jonë. Ky plan është i një rëndësie të veçantë për të rinjtë. Ne si GP shpresojmë që ky plan të gjejë zbatim. Si GP e mbështesim miratimin e tij.

Meliza Haradinaj, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu miratimin e këtij projekt plani. Ajo shprehu dëshirën që kjo të mos mbetet vetëm në letër, por të zbatohet në praktikë, me të gjitha predispozitat që janë në këtë projektplan.

Shefki Gashi ngriti shqetësim rreth këtij propozimvendimi, duke thënë se këtë projektplan nuk e kam të qartë, andaj përderisa të mos bindem se vërtetë është për interes të rinisë, nuk do ta votojë.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu miratimin e këtij projektplani, me shpresë që të organizohen më mirë, t'i shfrytëzojnë të gjitha ato ndihma që kemi mundësi t'ua ofrojmë të rinjve, sepse më mirë është të luajnë diku përjashta, sesa të rrinë nëpër kafene. Kjo do të jetë e mira dhe interesi i rinisë përgjithësisht, por edhe i yni.

Afërdita Veliu, në emër të LV, tha se edhe grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar këtë plan dhe e kemi analizuar në detaje. Kemi ardhur në përfundim se ky plan vjen i stërvonuar dhe shumë jo serioz. Këtë e mendojmë për arsye se në kohë fushatash elektorale rinisë së qytetit i është premtuar shumë, bile-bile i është premtuar edhe parajsja, ndërsa sot rinia vazhdon të jetë kategoria gati më e pa perspektivë. Lidhur me këtë gjendje, kemi ardhur në përfundim se rinia e Prishtinës kërkon trajtim më serioz, kërkon krijimin e vendeve të reja të punës, mbi të gjitha, kërkon një arsim më cilësor dhe perspektivë për një të ardhme më dinjitoze, andaj grupi ynë parlamentar nuk do ta votojë një plan të tillë.

Me shumicë votash, dy kundër(Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu) dhe një abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e Planit të veprimtimit rinor lokal - Prishtinë 2013-2015.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve në pronësi të Komunës, informoi Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, i cili tha se bazuar në Ligjin për zjarrfikje dhe shpëtim dhe Udhëzimin për shpëtim nr. 21/2012, miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Komuna është e obliguar ta bëjë transferimin e Njësisë së zjarrfikësve në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, përkatësisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Sadri Ramabaja ngriti shqetësim lidhur me këtë propozimvendim, duke thënë se në mungesë të politikave serioze është krijuar kjo gjendje në Njësinë e zjarrfikësve, andaj përgjegjës për këtë janë si niveli qendror, ashtu edhe ai lokal. Kryetari e dha një shpjegim, por nuk ishte i saktë, nuk ishte gjithëpërfshirës. Zjarrfikësit janë në grevë, e me këtë vendim realisht ne e heqim përgjegjësinë që e kemi ndaj tyre. Ju bëjë thirrje që të gjitha obligimet që ka Komuna deri më aktin e kalimit, sipas këtij vendimit, në kompetencë të nivelit qendror, duhet t'i shlyejë Komuna ndaj zjarrfikësve.

Meqë mbështetet në ligjin, ne e votojmë këtë vendim për miratim.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Ramabaja, **kryesuesi** dha sqarime shtesë.

Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve në pronësi të Komunës.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Nëntë Jugoviq, kryesuesi tha se kërkesa për një lokacion të tillë ka

qenë prej komunitetit, sepse varrezat e fshatit Nëntë Jugoviq kanë qenë në Bërnice dhe ka qenë kërkesë imediate që është me kohë.

Hetem Kupina tha se duke e pas parasysh kërkesën e qytetarëve, Grupi parlamentar i LDK-së e shqyrtoi edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe pa kurrfarë hezitimi jep pëlqimin për miratim.

Sadri Ramabaja tha se kjo laramani e dokumenteve rreth emërimit të vendbanimit më irriton. Le të shënohet edhe në vendim se është fjala për Bardhosh dhe e marrim vesh të gjithë.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Nëntë Jugoviq.

Pika e tetë dhe e nëntë

Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e mjeteve NPL "Trafiku Urban" dhe Propozimvendimin për lejimin e mjeteve NPL "Pastrimi" në Prishtinë, arsyetimin për dhënien e këtyre mjeteve e dha Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Shefki Gashi shprehu përkrahje për këto propozimvendime, por kërkoi që menaxherët e këtyre ndërmarrjeve t'i marrin punët pak më seriozisht, të jenë më të përgjegjshëm.

Sadri Ramabaja tha se në parim jemi që t'i mbështesim dhe do t'i votojmë për miratim, por dua ta potencoj një fakt. Këto janë ndërmarrje publike, të cilat po menaxhohen nga militantë partiakë. Le të kujtojmë faktin që drejtori i ndërmarrjes "Pastrimi" me të shkuar atje, ka blerë një veturë në vlerë 30.000 apo 40.000 € etj., kaq sa po japim ne sot, por ky Kuvend a i ka kërkuar atij llogari.

Përderisa ndërmarrjet publike trajtohen në këtë mënyrë dhe nuk dërgohen ekspertë që të menaxhojnë me to, ne do të kemi probleme dhe do detyrohemi që, për hir të qytetarëve, të marrim vendime të tilla. Pra, çështja është te mungesa e përgjegjësisë prej të dërguarve si menaxherë atje, e deri te ata që i delegojnë, respektivisht ne që po i votojmë këtu.

Njëzëri u miratuan Vendimi për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", në Prishtinë dhe Vendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" në Prishtinë.

Pika e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë

Lidhur me Propozimvendimin për fletëtransfer të mjeteve financiare dhe Propozimvendimin për transfer të mjeteve financiare në shumën prej 100.000 €, mjete të cilat barten në subvencione për bujq për të mbjellat vjeshtore, në pika të shkurtra informoi Xhelil Bekteshi.

Shefqet Sylejmani tha se e përkrahim këtë propozimvendim, por e kemi vetëm një sugjerim. Në Vendimin për pjesën e subvencioneve, konkretisht për pjesën e bujqësisë, propozoj që në nenin 2, aty ku përshkruhet me këto shifra 47006-21, të thuhet me fjalë, siç është te arsytimi në faqen tjetër, pra këto mjete jepen për këtë, këtë etj.

Shefki Gashi e përkrahu këtë propozimvendim, por me një sugjerim që Komuna të mos i mbetet borxh askujt, pra edhe punëtorëve të brendshëm që i kanë kaluar normat e orëve. Në këtë kategori do duhej të përfshiheshin edhe disa komisione, të cilat kanë bërë emërtimin e rrugëve dhe komisione tjera të fushëveprimeve të ndryshme.

Gjithashtu një propozim konkret për Sektorin e bujqësisë, që të ndahen mjete për mbarsim të kafshëve, dhe mbarsimi i kafshëve të mos bëhet vetëm për 5 - 6 muaj, por të jetë vjetor.

Afërdita Veliu tha se kur planifikimi i buxhetit nuk bëhet si duhet, atëherë ky Kuvend sillet para alternativave pa alternativë. Paaftësia e kësaj qeverie për planifikime të mirëfillta buxhetore, tash më është e dëshmuar. Madje, në rastin konkret, edhe kalkulimet janë të gabuara, meqë ne mendojmë se ideja nuk është të mbështeten shkollat, por të zvogëlohet suficiti i paralajmëruar.

Njëzëri u miratuan Vendimi për fletëtransfer të mjeteve financiare dhe Vendimin për transfer të mjeteve financiare, në shumën prej 100.000 €, mjete të cilat barten në subvencione për bujq për të mbjellat vjeshtore.

Pika e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje

Shefki Gashi tha se meqë ka filluar stina e dimrit, do të duhej të kishim këtu një raport të shkurtër lidhur me përgatitjet për mirëmbajtjen e rrugëve. Propozoi që të jetë një komision nga Drejtoria e Shërbimeve Publike apo Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, dhe të dalë në terren për të identifikuar vendet ku duhet të bëhet mirëmbajtja e përhershme. Edhe pikat tjera që janë të nivelit të ministrisë, siç është p.sh. pjesa e rrugës rreth liqenit të Badovcit, pjesë e cila nuk i ekspozohet diellit, janë disa pozicione shumë të vrazhda, shumë të vështira edhe në pjesën tjetër të malësisë. Janë edhe disa pjesë të qytetit, siç janë: rruga "Rrustem Statovci", rruga te Halla e sporteve, disa pjesë të rrugëve në lagjen "Vellusha" etj. Është edhe një pikë e zezë në fshatin Mramor, konkretisht te Bunari i Dukës, si dhe ana e prapme te Stallova, pika të cilat janë mjaft të rrezikshme gjatë sezonit të dimrit.

Shefqet Sylejmani parashtrroi tri çështje:

1. Kërkojmë me ngulm linjën e premtuar të autobusit që e shkurton linjën Kodra e Diellit - Plepat - Gërmi, për hir të pleqve, plakave, pensionistëve e

të tjerëve. Mendojmë që do të jetë njëra prej rrugëve më të arsyeshme ekonomikisht.

2. Lagja "Tophane" mbetet me problemet e para 13 vjetëve, me ato mjete motorike, si traktorët, rimorkiot, punëtorët e krahut dhe problemet tjera që i kemi përmendur shpesh.

3. Kërkojmë nga NPL "Hortikultura", që të përkujdeset për pjesën e hapësirës në kompleksin banesor "Dielli" në Prishtinë, që Drejtoria e Shërbimeve Publike ta bëjë hapjen e pusit, ndërsa Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ndërtimin e një fushe të sportit.

Mejreme Berisha kërkoi nga kryesuesi që ta përdorë autoritetin e tij dhe të kërkojë nga këshilltarët, që mos ta lëshojnë mbledhjen pikërisht kur për diskutim janë pikat: pyetje, përgjigje dhe të ndryshme.

Falënderoi komisionin përkatës që ka punuar për rrugën "Dëshmorët e Marecit", që e kanë liruar hapësirën me ato drejtimet që i kanë bërë. Dhe, siç tha, 101 pyetje tjera për të cilat nuk mori përgjigje, e që i kam rrumbullakuar dhe i kam llogaritur deri sot, dhëntë Zoti deri në fund të këtij mandati, diçka do të dalë prej tyre.

Meliza Haradinaj paraqiti një kërkesë të banorëve të lagjes "Qendra" të Prishtinës, saktësisht banesa prapa ndërtesës që sot e ka në shfrytëzim Banka Prokredit. Është lagje që është degraduar plotësisht prej faktorit të biznesit. Fjala është për kafenetë që punojnë nëpër ndërtesa banimi aty përreth, edhe çka është më e keqja që kanë leje pune nga Komuna, sidomos pjesa që i është dhënë në shfrytëzim Bankës Prokredit për parkingun mbrapa ndërtesës të cilën e shfrytëzon, i cili parking e degradon dhe e zvogëlon parkingun për banorët që jetojnë nëpër ato hapësira.

Këta banorë janë të indinjuar prej këtij degradimi, andaj kërkojnë nga organet komunale që faktori njeri të jetë prioritet karshi faktorit biznes. Gjithashtu kërkojnë që lejet e punës për kafene, nëse nuk tërhiqen plotësisht, atëherë orari i punës të jetë më së shumti deri në orën 11 -12 .

Por, edhe leja e parkingut të Bankës Prokredit të jepet për në anën tjetër të Radio Prishtina ose të bëhet një zgjidhje tjetër.

Shaip Hajrizi, pyetje për Drejtorinë e Arsimit

Dihet se para disa muajve e kemi miratuar vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një shkolle dhe një çerdheje në lagjen "Kodrën e Trimave", por e dimë edhe anën tjetër që ai lokacion tash për tash është i diskutueshëm.

Kam disa informata që çerdhja mund të dështojë. Kisha kërkuar që, meqenëse është paraparë me buxhetin e vitit të ardhshëm, ajo çerdhe të mos dështojë, pra të bartet në vendin afër shkollës "Hilmi Rakovica", ku ka qenë kërkesë para 4 - 5 vjetëve dhe janë dy parcela që janë të lira, nuk janë të uzurpuara.

E dyta, ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Pyes drejtorin se kur ka gjasa që një linjë të autobusit që e kemi miratuar në relacionin Kodra e Trimave – Gërmë, ka apo nuk ka gjasa të fillojë punën.

E kam bërë një kërkesë në emër të prindërve të shkollës fillore “Asim Vokshi”, që një antenë në afërsi të shkollës, të hiqet nga atje. Ajo nuk është hequr, por nuk e di a ka dalë Drejtoria e Inspektionit me shikuar për këtë çështje.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z, Hajrizi, **Kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Hetem Kupina, pyetje për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Bashkësia Lokale e Bardhoshit, në kuadër të së cilës përfshihen 7 fshatra, me 8731 banorë të regjistruar në kuadër të kësaj BL-je, deri në fillim të këtij mandati ka pasur shtëpi të kulturës, që shumë kush ia ka pasur lakminë, ka pasur bibliotekë, ka pasur fushë sporti për futboll, hendboll dhe basketboll, por sot asnjërin prej këtyre nuk e ka. Pyes se cili është kontributi i kësaj drejtorie që të ndodhë kjo që ka ndodhur, ose pse ndodhi kjo që ka ndodhur, dhe cili është vizioni i kësaj drejtorie që në të ardhmen të ndërmerë diçka për t’iu siguruar të rinjve tanë diçka më të mirë?

Do të dëshiroja të ma jepni përgjigjen me shkrim.

Sadri Ramabaja, pyetje për Drejtorinë e Arsimit

Ata që e kanë lexuar me vëmendje ekstraktin, e shohin se pyetja ka qenë e shtruar në mbledhjen e kaluar, dhe përgjigja do duhej të ishte sot këtu, në fakt të jepej me shkrim, ashtu siç iu është dhënë të tjerëve. Fjalën e kam për pyetjen që i është dedikuar Drejtorisë së Arsimit, konkretisht se sa mësimdhënës në të gjitha nivelet, por me theks të veçantë e kam cekur në gjimnazin “Sami Frashëri”, janë punësuar këtë vit jashtë institucionit të konkursit.

Kërkoj të më jepet përgjigje me shkrim në mbledhjen e ardhshme.

Rexhep Mustafa, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

A e ka në program për vitin 2013 drejtoria përkatëse, ta ketë në mbikëqyrje ruajtjen e ambientit në tërë territorin e komunës?

Gjendja është alarmante. Në çdo vend hidhen mbeturina të të gjitha llojeve. Të gjitha rrjedhat e ujërave natyrale janë të kontaminuara nga mbeturinat. Lumi Llap është bërë depo e hedhjes së mbeturinave.

Është kërkesë e qytetarëve që të merren masa për ndërprerjen e kësaj dukurie negative dhe të dëmshme.

Mbledhja mbaroi në orën 12:35.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dip.